



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 03.nëntor 2011
Nr. ref.: RK 153/11

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 70/10

Parashtruesi

Fatime Kabashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. nr. 28/2010, të datës 30 qershor 2010**

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruese e kërkesës është znj. Fatime Kabashi, me banim në Prizren, përfaqësuar nga Dr. sc. Hazër Susuri, avokat në Prizren.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar nga parashtruesja e kërkesës është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Rev. nr. 28/2010, i datës 30 qershor 2010, i cili iu dorëzua parashtrueses së kërkesës më 13 korrik 2010.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesja e kërkesës pretendon shkeljen e nenit 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullit 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 30 korrik 2010, parashtruesja e kërkesës ka paraqitur kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 26 gusht 2010, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme.
7. Më 21 tetor 2010, me Urdhrin e Kryetarit Nr. GJR. 70/10, gjyqtarja Snezhana Botusharova u emërua si Gjyqtare raportuese. Po të njëjtën ditë, Kryetari me Urdhrin Nr. KSH. 70/10, emëroi Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve Ivan Čukalović (kryesues), Enver Hasani dhe Iliriana Islami.
8. Më 19 janar 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesja e kërkesës dokumente shtesë, e cila i dorëzoi ato po atë ditë.
9. Po të njëjtën ditë, Gjykata kërkoi komplet dosjen e rastit nga Gjykata Komunale në Prizren, e cila i dorëzoi ato më 28 janar 2011.
10. Më 21 shkurt 2011, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i bëri rekomandimet Gjykatës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 1 shtator 2003, parashtruesja e kërkesës nënshkroi kontratë pune të vlefshme prej 1 shtatorit 2003 deri më 31 gusht 2004, për pozitën e mësueses në shkollën "Lekë Dukagjini" në Prizren (në tekstin e mëtejme: Punëdhënësi). Kjo kontratë pune u transformua në kontratë pune me afat të pacaktuar.
12. Më 23 janar 2004, kërkesa e parashtrueses së kërkesës për pushim, që të vizitonte vajzën e saj në Zambit, nga data 26 janar 2004 deri më 26 shkurt 2004, u aprovua nga Departamenti i Arsimit dhe Shkencës në Prizren.
13. Më 7 dhjetor 2004, parashtruesja e kërkesës kërkoi edhe njëherë pushim pa pagesë, kësaj radhe prej 17 janar 2005 deri më 21 shkurt 2005, që të vizitonte vajzën e cila pritej të lindte.

14. Më 23 dhjetor 2004, Departamenti i Arsimit dhe Shkencës në Prizren refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës, sepse pushimi pa pagesë jepej vetëm (1) për fëmijën e porsalindur dhe ky mund të miratohej vetëm në rast se nuk ishte askush tjetër që të kujdesej për të, dhe (2) për trajtim mjekësor jashtë vendit. Sidoqoftë, parashtruesja e kërkesës mori pushimin dhe shkoi në Zambì.
15. Më 12 janar 2005, parashtruesja e kërkesës vizitoi repartin e emergjencës në Spitalin Universitar në Lusakë, Zambì, ku mjeku i përshkroi parashtrueses së kërkesës pushim shtrati për dy javë dhe shmangie të udhëtimit.
16. Më 23 janar 2005, punëdhënësi u njoftua nga pala e tretë se parashtruesja e kërkesës është sëmurë dhe nuk mund të udhëtojë derisa të përmirësohet. Punëdhënësi më vonë u njoftua se parashtruesja e kërkesës e pranoi shkresën e tij, me të cilën refuzohet kërkesa e parashtrueses së kërkesës për pushim pa pagesë, por pasi që ajo veç kishte paguar biletat dhe përgatitur gjithçka për udhëtim, nuk kishte kthim prapa.
17. Më 24 janar 2005, parashtrueses së kërkesës iu ndërpre kontrata e punës, për shkakun se ajo kishte munguar nga puna dhe kishte shkelur Udhëzimin Administrativ Nr. 2003/2 për implementimin e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/36, për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ 2001/36), neni 30.1 (b), (c), (d) dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ të Ministrisë së Shkencës dhe Teknologjisë (Nr. 44/2004), të 24 gushtit 2004 (në tekstin e mëtejme: Udhëzimi Administrativ 44/2004).
18. Më 26 janar 2005, parashtruesja e kërkesës përsëri vizitoi repartin e emergjencës së Spitalit Universitar në Lusakë, Zambì.
19. Më 1 mars 2005, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë në Departamentin e Arsimit dhe Shkencës në Prizren, duke deklaruar se kishte qenë e sëmurë dhe se e kishte njoftuar punëdhënësin se cilat ishin arsyet pse ajo nuk kishte mundur të vijë në punë.
20. Më 4 mars 2005, Departamenti i Arsimit dhe Shkencës në Prizren hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë dhe mbështeti vendimin për ndërprerjen e kontratës së punës.
21. Më 15 mars 2005, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë kundër vendimit të Departamentit të Arsimit dhe Shkencës në Prizren, në Zyrën Regjionale të Ministrisë së Arsimit në Prizren, e cila më 21 mars 2005, hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë.
22. Më 6 qershor 2005, parashtruesja e kërkesës paraqiti ankesë kundër vendimit të Zyrës Regjionale të Ministrisë së Arsimit në Prizren, në Zyrën e Inspektoratit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës e Teknologjisë.
23. Më 11 korrik 2005, parashtruesja e kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar anulimin e vendimit për ndërprerjen e kontratës së punës. Parashtruesja e kërkesës pohon se e ka njoftuar punëdhënësin se ishte jashtë vendit dhe se ishte sëmurë. Prandaj, nuk mundi të kthehej në punë.
24. Më 13 janar 2006, Zyra e Inspektoratit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë hodhi poshtë ankesën e parashtruese së kërkesës si të pabazë. Parashtruesja e kërkesës duket se nuk është ankuar ndaj këtij vendimi në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, brenda afatit prej 30 ditësh.
25. Më 5 prill 2006, Gjykata Komunale në Prizren mbështeti ankesën e parashtrueses së kërkesës, duke anuluar vendimin për ndërprerjen e kontratës së punës si të paligjshme,

sepse parashtruesja e kërkesës kishte arsye për të munguar, pasi që ishte sëmurë (C. nr. 527/05).

26. Punëdhënësi parashtroi ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren, e cila më 6 tetor 2006, mbështeti ankesën e punëdhënësit, duke anuluar aktgjykimin Gjykatës Komunale dhe e ktheu atë në Gjykatën Komunale për rigjykim (Ac. nr. 341/06). Gjykata e Qarkut konkludoi se parashtruesja e kërkesës e ka shpërfillur vendimin e punëdhënësit, me të cilin refuzoi kërkesën e parashtrueses së kërkesës për pushim pa pagesë. Se parashtruesja e kërkesës u sëmur derisa po vizitonte bijën e saj, nuk është arsye e vlefshme për mungesë nga puna.
27. Më 26 mars 2008, Gjykata Komunale rigjykoi rastin dhe mbështeti kërkesën e parashtrueses së kërkesës duke anuluar ndërprerjen e kontratës së punës. Gjykata Komunale konkludoi se nuk kishte baza ligjore sipas Udhëzimit Administrativ 44/2004 për punëdhënësin për të ndërprerë kontratën e punës. Për më tepër, punëdhënësi nuk ka vepruar në pajtim me Rregulloren e UNMIK -ut Nr. 2001/27 për Ligjin Bazë të Punës në Kosovë (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut 2001/27).
28. Punëdhënësi paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut, e cila, më 6 nëntor 2009, hodhi poshtë ankesën dhe mbështeti Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (Ac. Nr. 284/08). Gjykata e Qarkut konkludoi se Gjykata Komunale me korrektësi ka zbatuar të drejtën materiale dhe me korrektësi ka vërtetuar gjendjen faktike. Retried
29. Më 25 nëntor 2009, punëdhënësi paraqiti ankesë në bazë të neneve të ligjit në Gjykatën Supreme ndaj Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut dhe Gjykatës Komunale, duke pretenduar se Gjykata Komunale nuk kishte juridiksion të vendoste, sepse kjo ishte një çështje administrative dhe se parashtruesja e kërkesës duhej t'i kishte drejtuar ankesën Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejme: KPM) i cili ishte kompetent të vendoste për çështjet që u përkasin shërbyesve civil.
30. Më 30 qershor 2010, Gjykata Supreme anuloi aktgjykimet e Gjykatës së Qarkut dhe asaj Komunale dhe hodhi poshtë ankesën e parashtrueses së kërkesës si të pabazë, duke deklaruar se gjykatat e instancës më të ulët kishin gjykuar gabimisht situatën faktike si dhe kishin zbatuar gabimisht të drejtën materiale (Rev. I. nr. 28/2010). Sipas mendimit të Gjykatës Supreme, parashtruesja e kërkesës ka munguar nga puna pa autorizim, edhe pse ishte informuar një ditë para se të refuzohej kërkesa e saj për pushim pa pagesë. Në lidhje me të drejtën materiale, Gjykata Supreme rithekson se Rregullorja e UNMIK-ut 2001/36 dhe Udhëzimi Administrativ 44/2004 ishin në fuqi në vend të Rregullores së UNMIK-ut 2001/27.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

31. Parashtruesja e kërkesës pretendon se Gjykata Supreme me nxjerrjen e aktgjykimit të vet ka shkelur nenin 49 të Kushtetutës i cili përcakton se e drejta e punës është e garantuar nga shteti. Ajo thotë se asaj i është mohuar kjo e drejtë nga autoriteti gjyqësor shtetëror, gjegjësisht, Gjykata Supreme përmes aktgjykimit të vet antikushtetues.
32. Parashtruesja e kërkesës pretendon se është pushuar nga puna pa ndonjë arsye ligjore dhe se kontrata e saj e punës është ndërprerë, pa ndonjë bazë ligjore, në mënyrë arbitrare nga punëdhënësi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

33. Sa i përket pretendimeve të parashtrueses së kërkesës se është shkelur neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimi të profesionit] i Kushtetutës, Gjykata vëren se, për të qenë në gjendje të gjykojë mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, është e nevojshme paraprakisht të vlerësohet nëse parashtruesja e kërkesës i ka plotësuar të gjitha kushtet e pranueshmërisë të cilat përcaktohen me Kushtetutë, specifikuar me Ligj dhe Rregullore të punës.
34. Lidhur me këtë, duhet referuar nenit 47.2 të Ligjit, ku thuhet se:
- Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
35. Arsyetimi mbi kërkesën për shterim është që t'u ofrohet autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësia për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive ligjore për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shihni: Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin e Universitetit AAB-RIINVEST kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, Rasti KI 41/09 i janarit 2010, dhe mutatis mutandis, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25803/94, Vendim i datës 28 korrik 1999).
36. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës, si shërbyes civil, mund të kishte paraqitur ankesë kundër shkarkimit të saj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës, i cili është organi kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur lidhur me ankesat ndaj autoriteteve publike. Megjithatë, duket se parashtruesja e kërkesës nuk e ka shfrytëzuar fare këtë mjet ligjor.
37. Gjykata, megjithatë, konkludon se në këtë rast parashtruesja e kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.
38. Për më tepër, parashtruesja e kërkesës nuk mund të ankohet se gjykatat e rregullta kanë bërë gabime të fakteve ose ligjshmërisë, përveç nëse ato t'i kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë.
39. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se nuk duhet të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt kur shqyrtohen vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Gjykatat e rregullta kanë për detyrë t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës (GC), nr. 30544/96, par. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
40. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse procedurat, shikuar në tërësi, janë kryer në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur një gjykim të ndershëm (shih, *mutatis mutandis*, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Apl. Nr. 13071/87 miratuar më 10 korrik 1991).
41. Në rastin konkret parashtruesja e kërkesës ishte e suksesshme në paditë e saj në Gjykatën Komunale dhe atë të Qarkut, por Gjykata Supreme i anuloi vendimet e gjykatave të rregullta për zbatim të gabueshëm të të drejtës materiale. Në këtë rast, Gjykata vëren se parashtruesja e kërkesës nuk ka dëshmuar pse vendimet e Gjykatës Supreme ishin të padrejta apo arbitrare (shih *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituaniës, Vendimi i GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë e kërkesës nr_17064/06, të 30 qershorit 2009).

42. Prandaj, Gjykata përfundon se parashtruesja e kërkesës as nuk e ka arsyetuar ankesën e saj lidhur me shkeljet e pretenduara dhe as nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në përputhshmëri me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, me shumicë votash

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani